



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac / Municipality Rahovec

Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu

Nr. i prot. 6428 Më 08.12.2023
Br. prot. 08.12.23
RAHOVEC - ORAHOVAC

FTESË PUBLIKE

**PËR BIZNESE PËR FURNIZIM ME FIDANE DHE MATERIAL TJETER TË NEVOJSHËM
PËR KULTIMIN E TRANGULLIT "KORNISHAN"**

Udhëzimet për Aplikantët

Data e hapjes së ftesës publike: 08.12.2023

**Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve: 7 ditë dhe përfundon me datën 15.12.2023 ora
12:00**

1. Ftesë publike për furnizim me fidane dhe material tjetër të nevojshëm për kultimin e trangullit "Kornishan" fushat e përkrahjes së projekteve:

- a) Komuna e Rahovecit njihet në vendin tonë si komuna me kultivimin më të madh të perimeve si në fushë të hapur e poashtu edhe në sipërfaqe të mbrojtura - Serra.
- b) Në vitet e kaluara investimi kryesor i komunës së Rahovecit ka qenë ndërtimi i serrave për fermerë individual.
- c) Tani kur ky proces ka përfunduar duke i përmbyllur kontratat e ndërtimit të serrave dhe fokusi i komunës sonë është stimulimi i fermerëve që të kultivojnë produkte bujqësore si për tregun vendor poashtu edhe për tregun e jashtëm.

1.2 Objektivat e ftesës publike

Duke u bazuar edhe në planifikimin tonë afatmesëm i cili është i pasqyruar edhe në KAB (kornizën Afatmesme Buxhetore) ku prioritetet dhe objektivat e Drejtorisë së BPZHR-së janë edhe;

- d) Përkrahja e fermerëve me farëra, plehëra dhe inpute bujqësore
- e) Përkrahja për fidanishte dhe prodhimin e fidanëve cilësorë,
- f) Zbatimi i projekteve që prekin direkt fermerët kultivues të perimeve

Qëllimi dhe objektivi e përgjithshme e kësaj thirrjeje publike është subvencionimi dhe mbështetja financiare për furnizim me fidane dhe material tjetër të nevojshëm për kultimin e trangullit "Kornishan" për fermerët e komunës së Rahovecit.

2. KUSHTET FORMALE TË FTESËS PUBLIKE

2.1. Kush mund të aplikoj?

Të gjitha Bizneset e komunës së Rahovecit që merren me grumbullimin, përpunimin dhe tregëtimin e produkteve bujqësore, me theks të veçantë Trangullit,

2.2 Shpenzimet e pranueshme që do të financohen për këtë ftesë publike

Nëpërmjet fondeve publike të kësaj ftese publike mund të financohen vetëm kostot reale dhe të pranueshme për realizimin e aktiviteteve të projektit, në periudhën kohore të specifikuar me këto udhëzime. Në vlerësimin e projektit do të vlerësohen vetëm kostot e nevojave në lidhje me aktivitetet e planifikuara, si dhe në lartësinë reale të këtyre shpenzimeve.

3. VLERA E PALNIFIKUAR E MBËSHTETJES FINANCIARE

Për mbështetje financiare publike për projektet sipas thirrjes publike është e paraparë shuma prej 56,000 euro.

4. SI TË APLIKONI?

Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen me postë ose personalisht, në adresën e mëposhtme:

Zyra e pranimi në katin e parë në objektin e Komunës.

Procesi i pranimi, hapjes dhe shqyrtimi aplikacioneve, vlerësimi të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendarin tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në Udhëzimet për aplikuesit e ftesës publike.

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë ftesë publike, dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të ftesës publike.

4.1 Aplikacioni i projekt-propozimit

Plotësimi i formularit të projekt propozimit është pjesë e dokumentacionit të detyrueshëm. Ajo përmban të dhëna në lidhje me aplikuesit dhe përmbajtjen e projektit për të cilin kërkohet financim nga burimet publike.

Në rast se në formën e dorëzuar mungojnë të dhënat në lidhje me përmbajtjen e projektit, aplikimi nuk do të merret në konsideratë.

Formulari është i nevojshëm të plotësohet me kompjuter. Nëse formulari është plotësuar me dorë nuk do të merret në konsideratë.

4.2 Përmbajtja e formularit të Buxhetit

Formulari i propozim-buxhetit është pjesë e dokumentacionit të detyrueshëm. Propozim- buxheti i dorëzuar duhet të përmbajë informacion për të gjitha shpenzimet direkte dhe indirekte të projektit të propozuar për financim.

Nëse formulari i buxhetit nuk është i plotësuar në tërësi, apo nuk është dorëzuar në formën përkatëse, aplikimi nuk do të merret në konsideratë.

4.3 Ku ta dorëzoni aplikimin?

Formularët e detyrueshëm dhe dokumentacioni i kërkuar duhet të dërgohen në formë fizike, të shtypur (një origjinal). Formularët duhet të jenë të nënshkruar nga përfaqësuesi i autorizuar dhe të vulosur me vulën zyrtare të organizatës.

Aplikimi origjinal duhet të dorëzohet në sportelin e pranimi në katin e parë të objektit të Komunës. Në pjesën e jashtme të zarfit duhet të shënohet emri i thirrjes publike, së bashku me emrin e plotë dhe adresën e aplikuesit dhe shënimin për fushën përkatëse për të cilin aplikon.

4.4 Afati i fundit për dërgimin e aplikacioneve

Afati i thirrjes është: 7 ditë, përkatësisht prej datës 08.12.2023 deri më datë 15.12.2023 ora 12:00.

Në rast se kërkesa është paraqitur personalisht në zyrën e pranimi, aplikantit do t'i lëshohet një vërtetim se aplikacioni është pranuar brenda periudhës së konkursit.

Të gjitha aplikacionet e dërguara pas afatit nuk do të merren parasysh.

4.5 Si të kontaktoni nëse keni ndonjë pyetje?

Të gjitha pyetjet në lidhje me thirrjen mund të bëhen vetëm në mënyrë elektronike, duke i dërguar një kërkesë në adresën e mëposhtme: berat.duraku@rks-gov.net, jo më vonë se 3 ditë para skadimit të afatit.

Përgjigjet ndaj kërkesave të veçanta do të dërgohen direkt në adresën e pyetjeve të shtruara dhe përgjigjet më të shpeshta do të publikohen në faqen e mëposhtme të internetit: komuna.rahovec@rks-gov.net, dhe jo më vonë se 3 ditë para skadimit të thirrjes.

Për të siguruar trajtim të barabartë të të gjithë aplikantëve të mundshëm, një ofrues i mbështetjes financiare publike nuk mund të japë një mendim paraprak për pranueshmërinë e aplikantëve, veprimet apo shpenzimet e përmendura në kërkesë.

5. VLERËSIMI DHE NDARJA E FONDEVE

5.1 Aplikacionet e pranura do të kalojnë nëpër procedurat e mëposhtme:

- g) Ofruesi i mbështetjes financiare do të themeloj një komision vlerësues të përbërë nga
- h) 3 anëtarë, nga zyrtarë të institucionit dhe ekspertë tjerë të jashtëm, të cilët kanë për detyrë të vlerësojnë aplikacionet nëse i plotësojnë kushtet formale të thirrjes publike.
- i) Pas kontrollimit të të gjitha aplikacioneve të pranura, komisioni do të përgatis një
- j) listë të të gjithë aplikantëve që i plotësojnë kushtet për t'u vlerësuar përmbajtja e projekteve të tyre dhe një listë të aplikantëve, të cilët nuk i plotësojnë kushtet e përcaktuara të konkurrencës.
- k) DBPZHR do të njoftojë me shkrim të gjithë aplikantët të cilët nuk i plotësojnë kërkesat dhe arsyet e refuzimit të aplikimit të tyre.
- l) Në fazën e dytë do të bëhet vlerësimi i përmbajtjes së aplikimeve nga ana e Komisionit vlerësues i përbërë nga 3 anëtarë. Çdo aplikacion i pranuar do të vlerësohet në bazë të formularit të vlerësimit.
- m) Lista e përkohshme e projekteve përfituese të përzgjedhura për financim në bazë të vlerësimit të aplikacioneve, të cilat i kanë plotësuar kushtet e parashikuara të thirrjes, komisioni do të hartojë një listë të përkohshme të projekteve të përzgjedhura, sipas pikëve që ata kanë marrë në procesin e vlerësimit. Shuma totale e kostos së projekteve të radhitura në listën e përkohshme nuk do të kalojë shumën totale të ofruar për financim përmes thirrjes publike.

5.2 Dokumentacion shtesë dhe kontraktimi

Për të shmangur shpenzimet e panevojshme shtesë kur të aplikoni, DBPZHR do të kërkojë dokumentacion shtesë vetëm nga ata aplikantë të cilët, në bazë të procesit të vlerësimit të aplikacioneve, ka hyrë në listën e përkohshme të projekteve të përzgjedhura për financim.

Para nënshkrimit përfundimtar të kontratës dhe në bazë të vlerësimit të Komisionit, DBPZHR mund të kërkojë shqyrtimin e vijave buxhetore për kostot e vlerësuara që korrespondojnë me shpenzimet aktuale në lidhje me aktivitetet e propozuara.

Komisioni vlerësues do të bëjë kontrollimin e dokumentacionit shtesë.

Nëse përfituesi nuk paraqet dokumentacionin e kërkuar shtesë brenda kohës së caktuar (jo më pak se 3 ditë), përfituesi do të refuzohet.

Pas kontrollit të dokumentacionit të paraqitur, komisioni do të propozojë listën përfundimtare të projekteve të përzgjedhura për financim.

Njoftimi i aplikuesve - Të gjithë aplikantët, aplikimet e të cilëve kanë hyrë në procesin e vlerësimit do të jenë të informuar në lidhje me vendimin për ndarjen e projekteve.

6. KALENDARI I REALIZIMIT TË FTESËS PUBLIKE

Fazat e procedurës së thirrjes

1. *Afati i fundit për aplikimet: 15.12.2023*
2. *Afati i fundit për dërgimin e pyetjeve në lidhje me thirrjen: 3 ditë para mbylljes së Ftesës për Aplikim*
3. *Afati i fundit për publikimin e vendimit për ndarjen e fondeve publike dhe njoftimi i aplikantëve: 3 ditë pas përfundimit të Ftesës Publike*

7. LISTA E DOKUMENTEVE TË FTESËS PUBLIKE

Formularët mund ti tërhiqni personalisht në zyrat e DBPZHR-së në objektin e vjetër të Komunës së Rahovecit, si dhe mund ti shkarkoni në web-faqe të Komunës: komuna.rahovec@rks-gov.net

4. *Formulari i aplikacionit për projekt për furnizim me fidane dhe material tjetër të nevojshëm për kultimin e trangullit "Kornishan"*
5. *Formulari i propozim-buxhetit për furnizim me fidane dhe material tjetër të nevojshëm për kultimin e trangullit "Kornishan"*
6. *Deklarata nën Betim*



Drejtoria e DBPZHR-së